

A DO TE SPASTROHET GARDA E VJETER E USHTRISE?

Author: [IWPR staff](#)

Shkarkimi i shefit të shërbimeve të sigurimit të ushtrisë, i cili është një figurë konservatore, mund të jetë një shenjë se autoritetet janë të vendosura të spastrojnë oficeret pro Millosheviqit të cilët përpiqen të pengojnë bashkëpunimin me Perendimin.

Qeveria e re e Serbisë dhe Malit të Zi ka shkarkuar shefin e shërbimeve të sigurimit të ushtrisë, Gjeneralin Aco Tomiq, në një levizje e cila po përshendetet si një hap i madh drejt spastrimit të zyrtarëve politikisht të kompromentuar dhe drejt shpejtimit të integritetit të vendit në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Me 21 Mars, Keshilli i Lartë i Drejtësisë, VSO - i përbërë nga presidentet e republikave të Serbisë dhe Malit të Zi Natasha Miciq dhe Filip Vujanović, ministri i ri federal i mbrojtjes, Boris Tadiq, dhe presidenti i Serbisë dhe Malit të Zi, Svetozar Marović - kanë vendosur të shkarkojnë Tomiq.

Shkarkimi i Tomiq ka treguar se drejtuesit e rinj të shtetit po veprojnë me vendosmëri ndaj figurave të rëndësishme ushtarake të afërta me ish presidentin Jugosllav Vojislav Koshtunica të cilët janë të kompromentuar nga skandale politike.

Keto figura konsiderohen si një pengesë e madhe për bashkëpunimin me gjykatën e krimeve të luftës në Hagë, ICTY, e cila është një para kusht për integritetin e Beogradit në Programin e NATO-s për Partneritet për Paqe, dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

Drejtuesit e rinj federal kanë lënë të kuptohet se ndryshimet në personelin e ushtrisë do të vazhdojnë. Me 20 Mars, Marović ka thënë për të përditëshmen Vijesti në Podgoricë se ushtria duhet të përbehet nga njëzë "të cilët mendojnë se e ardhmja e tyre qëndron tek e ardhmja dhe jo tek e kaluara".

"Nuk mund të ndihmohet njëzë nëse thua se nuk duhet të bashkëpunojmë me Hagen. Nëse ka të tilla njëzë në ushtri atëherë në duhet të bëjmë dicka, ata do të zëvendësohen," ka thënë ai.

Që prej rrezimit të Slobodan Millosheviq në Tetor 2000, struktura e personelit e forcave Jugosllave (tani Ushtria e Serbisë dhe Malit të Zi) praktikisht kanë mbetur të paprekura. Në vend që të shkatërronte strukturat e vjetra dhe të reformonte institucionin, Koshtunica ka ruajtur statusin kuonë.

Ish presidenti federal ka mbajtur në postin e tij bashkëpunëtorin e ngushtë të Millosheviqit, Gjeneralin Nebojša Pavković, në krye të ushtrisë për më tepër se dy vjet, dhe ka vendosur lidhje të ngushta me shërbimet e sigurimit të ushtrisë të cilat janë anti reforme dhe anti perendimore. Në mesin e vitit 2001, Koshtunica ka caktuar Tomiq, një tjetër figurë të njohur konservatore, në postin e shefit të këtij shërbimi.

Në shkëmbim të mbështetjes për aleatet e vjetër të Millosheviqit, drejtuesit e ushtrisë kanë mbështetur pa rezervë Koshtunicën në përplasjet e tij me rivalët politik.

Reforma në ushtri është dashur të shtyhet deri sa Koshtunica është larguar nga posti i presidentit në vitin 2003, kur Jugosllavia është zëvendësuar nga një bashkim i ri me i lire ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi.

Pasi rivalët e tij politik erdhën në pushtet - të gjithë koleget e kryeministrit të vrarë Serb Zoran Djindjiq dhe

aleatit të tij Malazez, Milo Gjukanović - Marović dhe Tadić kanë njoftuar një reformë të thellë në rradhetë e ushtrisë.

Ata kanë thënë se prioritetet e qeverisë janë integrimi në Programin Partneritet për Paqe dhe bashkëpunimi me Gjykatën e Hagës.

Shumë zyrtarë perëndimorë mendojnë se të dyshuarit kryesorë për krime lufte, me në krye ish komandantin e Serbeve të Bosnjës Ratko Mlladić, po fshihen në Serbi dhe gëzojnë mbrojtjen e ushtrisë Jugosllave.

Tadić ka thënë për median më 21 Mars se ai mendon se Ushtria e Serbisë dhe Malit të Zi nuk po mbrojnë asnjë prej të akuzuarve të Hagës por gjithashtu ka thënë se ka nisur një hetim për të zbuluar nëse ushtarakët kanë qenë të përfshirë ndonjëherë në mbrojtjen e tyre.

Po atë javë, pas caktimit të kabinetit të ri federal, Tomić është shkarkuar. Emri i tij është përmendur vazhdimisht në median Serbe si një figurë ushtarake me lidhje të afërta me Koshtunicën.

Burime të afërta me qeverinë e Beogradit kanë sugjeruar se arsyeja për shkarkimin e tij ka qenë largimi i influencës së Koshtunicës në ushtri dhe spastrimi i ushtrisë nga kundërshtarët me kryesore të Hagës.

Dy skandale të mëdha politike, të cilat kanë tronditur qeverinë Serbe dhe kanë rënduar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duket se kanë qenë një shenjë që Koshtunica kishte përdorur ushtrinë në përplasjet e tij politike me rivalët e tij.

Vitin e kaluar, pa njoftuar as shtabin e përgjithshëm, policinë, apo qeverinë, shërbimi sekret i ushtrisë ka arrestuar zëvendës kryeministrin e Serbisë, Momčilo Perišić, dhe një diplomat amerikan, John Neighbor, me akuza për spiunazh dhe se kanë shkëmbyer dokumenta sekrete ushtarake.

Duke shkelur protokollin ndërkombëtar dhe politiken e qeverisë për vendosjen e lidhjeve me të ngushta me Uashingtonin - dhe duke vepruar sikur lufta e ftohtë të ishte ende në fuqi - ata i kanë mbyllur sytë diplomatit Neighbor dhe e kanë mbajtur atë të ndaluar për disa orë.

Skandalit i perfundoi me tërheqjen e diplomatit dhe shkarkimin e Perišić, por perseri vazhduan të shtroheshin pyetje në lidhje me arsyet e këtij veprimi të ushtrisë, i cili në fakt nuk është kryer as nga regjimi i Millosheviqit.

Një diplomat perëndimor është ankuar se ky veprim tregonte një pamje të habitshme të prioritetëve të ushtrisë. "Në vend që të merret me të dyshuarit për krime lufte si Ratko Mlladić... shërbimet sekrete të ushtrisë dhe Koshtunica janë munduar të fitojnë pike politike dhe kanë vepruar në mënyrë të ngjashme me Millosheviqin," ka thënë ai, "duke e paraqitur veten si patriotë, dhe rivalët e tyre politik si tradhëtarë dhe bashkëpunëtorë të perëndimit".

Një tjetër skandal ka shpërthyer kur Koshtunica me pas shkarkoi shefin e ushtrisë, Nebojša Pavković, pasi kishte arritur në përfundimin se aleati dikur besnik i tij kishte filluar të afrohej me rivalët e tij. Shkarkimi është pasuar me deklarinë e Pavković se Tomić dhe keshilltarët e Koshtunicës kishin menduar të përdornin forcat speciale të ushtrisë për të vendosur nën kontroll Zyren Informativë të Qeverisë Serbe, pasi kishin pasur informacion se ajo përdorej si një qendër për të përgjuar zyren e Koshtunicës.

Pavković tha se plani për përdorimin e komandove në operacion është ndaluar vetëm sepse ai dhe oficerë

te tjere, te cilet ishin informuar per kete veprim, kishin kundërshtuar ashpër kete propozim.

Skandali i trete ka shperthyer per ceshtjen e furnizimit me pajisje ushtarake per Irakun dhe mirembajtjen e pajisjeve ushtarake te regjimit te Bagdadit. Media ne Beograd ka thene se anetare aktiv te forcave te armatosura kane qene te perfshire ne kete tregti, e cila sipas diplomateve perendimore nuk mund te ishte organizuar pa dijenine e Tomiq.

Asnje prej ketyre skandaleve nuk eshte zgjidhur perfundimisht. Megjithate, dyshimet e shumta te zyrtareve nderkombetare se figura te rendesishme te ushtrise ishin perfshire direkt ose indirekt ne mbrojtjen e Mlladiq kane krijuar nje bindje te forte ne Perendim se Beogradit nuk mund ti besohej dhe nuk mund te integrohej ne institucionet nderkombetare deri sa ai te vendoste nen kontroll forcat e armatosura dhe ato te vendoseshin perfundimisht nen kontrollin civil.

Location: [Serbia](#)

Source URL: <https://iwpr.net/sq/global-voices/do-te-spastrohet-garda-e-vjeter-e-ushtrise>